



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 185/1 Prot

Tiranë, më 6/2/2017

**Lënda:** Mendim për projektvendimin "*Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për regjistrin elektronik shëndetësor kombëtar*".

**Drejtuar:** Znj. Ermonela VALIKAJ FELAJ

MINISTËR SHTETI PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN

Tiranë

E nderuar Znj. Felaj,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 669/1 Prot, datë 31.01.2017, projektvendimi "*Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për regjistrin elektronik shëndetësor kombëtar*", vlerësohet i hartuar konform kërkesave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Ndërkohë, sugjerojmë që pas fjalisë së parë të pikës 2 të projektvendimit të shtohet "*Përpunimi i të dhënave personale të shtetasve, subjekt i të dhënave, kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale*".

Gjithashtu, në pikën 8 "*Subjektet e interesuara*", në rubrikën "*Përshkrimi i procesit*" të shtohet "*...Shtetasi, subjekt i të dhënave, ushtron të drejtat e tij sipas parashikimeve të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.*

Në përputhje me përkufizimet e parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, në përmbajtje të projektaktit duhet të përdoret termi "*pëlqimin e informuar*" dhe jo "*miratimin e informuar*".

Në përfundim, sugjerojmë që administruesi i kësaj databaze të shtojë në politikën e privatësisë edhe këtë lloj përpunimi, të informojë subjektet e të dhënave mbi aksesin si dhe të drejtat që legjislacioni i mbrojtjes së të dhënave personale parashikon në mbrojtje të tyre.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI

